

Ngritja e shqetësimeve (Denoncimi)

Ne presim që të gjithë punonjësit dhe partnerët tanë tregtarë të veprojnë me integritet në përputhje me standardet e sjelljes të përshkruara në **Kodin tonë të Sjelljes**. Nëse dyshoni se është kryer një shkelje e ligjit ose e Kodit tonë të Sjelljes, atëherë duam që ju t'i ngrini këto shqetësime.

Kodi jonë i Sjelljes mund të gjendet në intranet dhe në: www.imperialbrandsplc.com. Ju mund të bëni pyetje rreth kodit e t'i dërgoni me email në Governance.Team@uk.imptob.com

Ka disa mënyra me anë të të cilave mund të ngrihen shqetësimet:

1. Ngritja e problemeve në nivel lokal

Nëse nuk ju duket e përshtatshme që ta bëni këtë, shqetësimet tuaja duhet t'i ngrini përpara menaxherit të stafit ose ekipit vendor të burimeve njerëzore. Ne kemi procese për të siguruar që shqetësimet të trajtohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjithë tërësinë e biznesit.

2. Ngritja e problemeve përpara drejtuesve tanë të lartë

Nëse nuk ju duket e përshtatshme që t'i ngrini problemet në nivel vendor, ose nëse i keni ngritur problemet në nivel vendor dhe besoni se përgjigja vendore është e pamjaftueshme, atëherë ju mund të kontaktoni secilin nga personat e mëposhtëm:

- Sekretaren/in e Kompanisë;
- Kontrolluesin Financiar të Grupit; ose
- Drejtorin e Burimeve Njerëzore të Grupit.

Telefononi në: +44 (0)117 963 6636 dhe thoni se ky është një problem kallëzimi.

Nëse preferoni që shqetësimet t'i ngrini me shkrim, nuk është problem, por na ndihmon nëse na thoni se si mund t'ju kontaktojmë. Letrën tuaj mund ta postoni në adresën:

The Company Secretary, 121 Winterstoke Road, Bristol BS3 2LL, United Kingdom Marked: 'Personal'	Faksi: +44 (0)117 966 7859 Emaili: whistle.blowing@uk.imptob.com .
---	--

3. Ngritja e problemeve duke përdorur Linjën e posaçme të jashtme Expolink

Ju mund të zgjidhni, në çdo fazë, që t'i ngrini shqetësimet tuaja duke përdorur shërbimin krejtësisht të pavarur të ofruar nga **Expolink**, i cili mund të kontaktohet me telefon, me email ose nëpërmjet internetit. Expolink do të sigurojë që shqetësimet tuaja të kalohen shpejt te personat e duhur:

- Linja telefonike e posaçme Expolink funksionon 24 orë në ditë, 7 ditë të javës (përveç 25 dhjetorit). Numri i telefonit është i ndryshëm për çdo shtet. Nëse nuk e dini numrin e saktë atëherë mund të shikoni tabelat vendore të afishuara ose mund të vizitoni www.expolink.co.uk, www.imperialbrandsplc.com ose intranetin e grupit
- Raportet mund të dërgohen me email tek Expolink në imperialtobacco@expolink.co.uk
- Raportet e bëra në internet mund të dërgohen nga faqja e internetit të Expolink www.expolink.co.uk duke përdorur kodin e hyrjes 'imperialtobacco'.

Garancitë tona për ju

Me aq sa është e mundur, ne do të ruajmë fshehtësinë e shqetësimeve të ngritura nga ju. Megjithatë, për të kryer si duhet hetimet, disa informacione mund të duhet të publikohen.

Ju mund të zgjidhni t'i ngrini shqetësimet tuaja në mënyrë anonime, nëse kjo lejohet nga ligji i shtetit ku punoni.

Ne nuk e tolerojmë hakmarrjen ndaj një individi, i cili zbulon një shkelje reale ose të dyshuar të kodit apo që ndihmon në një hetim. Megjithatë, nëse ngrihet një shqetësim keqdashës kjo mund të çojë në masa disiplinore.